



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

VENDIM

Nr. 339, datë 27.06.2023

PËR

**TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË KANCELARIT TË GJYKATËS
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, nenin 80, nenin 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 557, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, kompetencat dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit” të ndryshuar, vendimin e Këshillit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.14, datë 02.06.2023 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe përshkrimet e punës të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, vendimit të KLGJ nr. 303, datë 05.06.2023 “Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër”, si dhe në vendimin propozues nr.3260/2 prot., datë 07.06.2023, të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër,

VENDOSI:

1. Znj. {...}, ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin Shef Sektori, në Sektorin e Koordinimit të Zyrave të Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 01.07.2023.
3. Njoftimin e këtij vendimi znj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR